

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 27.02.2023 (dymijë e njëzet e tre), palët kontraktuese ranë dakord për hartimin e kësaj kontrate shitblerje kuotash kapitali, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), statutit të shoqërisë "DELTA PHARMA-AL" SHPK, Vendimit datë 24.02.2023 të shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK, Vendimit datë 24.02.2023 të shoqërisë "DELTA PHARMA-AL" SHPK me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Palët

Pala Shitëse:

z. Eduard Curraj, shtetas shqiptar, lindur më 13.10.1973 në Jeran dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033871246 dhe nr. personal H31013028R.

Dhënës Pëlqimi:

znj. Marjana Curraj, shtetase shqiptare, lindur më 11.02.1979 në Ivanaj dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033871238 dhe numër personal H95211035K, në cilësinë e bashkëshortes së z. Eduard Curraj.

Pala Blerëse:

Shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, shoqëri tregtare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 16.01.2023, me NUIS (NIPT) M31316015P, me zyrë qendrore në Tiranë, Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, Zona Kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1, Mëzez, Kashar, e përfaqësuar nga administratori znj. **Ewa Maria Kokot**, lindur me 18.05.1962, në Czystochowa, Poloni, dhe rezidente në Shqipëri, në adresën rruga "Tish Daia", hyrja 2, ap. 49, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës nr. EL5804363 dhe numër personal 62051804767.

Kushtet Paraprake



- Shoqëria "DELTA PHARMA-AL" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 27.04.2006, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) K62202046U; me zyrë qendrore në Tiranë, Autostrada Tiranë – Durrës, km.3, zona kadastrale 2679, nr. pasurie 19/27/1, me kapital të regjistruar 903,046,506 (nëntëqind e tre milionë e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë; me ortakë z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- Pala shitëse do të shesë kuotat të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DELTA PHARMA-AL" SHPK dhe pala blerëse do të blejë këto kuota;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

Neni 2

Objekti

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Eduard Curraj, i shet palës blerëse shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK, kuotën që ai zotëron në shoqërinë "DELTA PHARMA-AL" SHPK e cila përbën 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.



Neni 3 **Çmimi**

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës që z. Eduard Curraj zotëron në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, objekt i kësaj kontrate, është 903,046,506 (nëntëqind e tre milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK, në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse.

3.2 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes do të paguhet palës shitëse brenda një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare, afat i cili fillon nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate. Nëse pala blerëse nuk paguan çmimin brenda këtij afati palët bien dakord se do të respektojnë parashikimin e nenit 5.3 të kësaj kontrate

3.3 Brenda një afati 90 ditor nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate pala blerëse do të paguajë palës shitëse një vlerë 3,046,506 (tre milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë si pjesë e çmimit të kontratës. Për pjesën tjetër të pagimit të çmimit pala blerëse do të vendosë me vendim asambleje herë pas here për pagimin e çmimit/dhe ose pjesë të çmimit të kontratës, derisa çmimi të shlyhet tërësisht brenda afatit të rënë dakord nga palët në këtë kontratë.

Neni 4 **Kalimi i Pronësisë**

4.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, pavarësisht se çmimi i saj do të paguhet përgjatë një afati 10 vjeçar, do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK do të bëhet ortakë në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

4.2 Në momentin e regjistrimit të kësaj kontrate sipas nenin 5.1, pronësia mbi kuotën e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, do të kalojë nga pala shitëse z. Eduard Curraj, tek pala blerëse shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK.

4.3 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë mbi kuotën e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse, shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK.

Neni 5 **Të Drejta dhe Detyrime të Palëve**

5.1 Palët bien dakord që në momentin që pronësia mbi kuotën kalon tek shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK, kjo e fundit do të gëzojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i burojnë nga zotërimi i kuotës.


5.2 Palët bien dakord që pas kalimit të kuotës nga pala shitëse, z. Eduard Curraj do të vazhdojë të jetë administrator i shoqërisë “DELTA PHARMA - AL” SHPK.

5.3 Nëse pala blerëse nuk paguan çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate atëherë palët dakordësojnë që mund të ripërtërijnë afatin e pagesës së çmimit të kontratës edhe me 5 (pesë) vjet të tjera, duke marrë parasysh dhe gjendjen financiare të shoqërisë blerëse, si dhe aktivitetin tregtar të saj.

Neni 6 **Dhënësi i Pëlqimit**

6.1 Dhënësja e pëlqimit znj. Marjana Curraj, bashkëshorte e ortakut Eduard Curraj dhe bashkëpronare për efekt martese në kuotën që z. Eduard Curraj zotëron në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, deklaron se është dakord që kuota, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortit të saj, t'i shitet shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK.

Dhënësja e pëlqimit deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimarrje të bashkëshortit të saj për shitjen e kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me



këtë shitje dhe me sa është deklaruar e rënë dakord midis palëve në këtë kontratë, apo me çdo vendimarrje tjetër që z. Eduard Curraj po ndërmerr e do ndërmarrë, në marrëdhënien tregtare me shoqërinë "DELTA HOLDING" SHPK.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një original regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një original e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë prej palëve, ata deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar dhe e nënshkruajnë atë rregullisht. Zonjës Ewa Maria Kokot kjo kontratë iu përkthye në gjuhën angleze nga Lindita Tema, person i besuar prej saj.

PALA SHITËSE

EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj
lij

DHËNËSJA E PËLQIMIT

MARJANA CURRAJ

Marijana Curraj [signature]

PALA BLERËSE

SHOQËRIA "DELTA HOLDING" SHPK
përfaqësuar nga administratori
EWA MARIA KOKOT

Ewa Kokot
Ewa Kokot



VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
“DELTA HOLDING” SHPK

Sot, në datën 24.02.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) M31316015P, me zyrë qendrore në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, zona kadastrale 2679, nr. pasurie 19/27/1, Mezëz, Kashar, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) .

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë prezent ortakët e shoqërisë të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- z. Dorian Sadiku, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- blerjen nga shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK të kuotave të zotëruara nga z. Eduard Curraj në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK;
- përcaktimin e çmimit të blerjes, pagimin e këtij çmimi, kalimin e kuotës dhe të drejtat e detyrimit e palëve, sipas tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi;
- autorizimin e administratorit të shoqërisë për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes;
- të ndryshme.


Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme me unanimitet:

V E N D O S I


- 1) Blerjen nga shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK të kuotave të zotëruara nga z. Eduard Curraj në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.
- 2) Çmimi i blerjes së kuotave do të jetë në vlerën 903,046,506 (nëntëqind e tre milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë. Çmimi i blerjes do të paguhet brenda një afati 10 vjeçar, duke pasur të drejtën palët të ripërtërijnë këtë afat edhe për 5 vjet të tjera, duke marrë parasysh gjendjen financiare të shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK si dhe aktivitetin tregtar të saj.
- 3) Miratimin e tekstit të kontratës së shitblerjes së kuotës, sipas draftit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 4) Autorizohet administratori i shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK. znj. Ewa Maria Kokot që të nënshkruajë për emër dhe llogari të shoqërisë, kontratën e shitblerjes së kuotës të miratuar sipas pikës 3 të këtij vendimi.
- 5) Ngarkohet administratori i shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK, që në respektim të zbatimit të këtij vendimit, të kryejë vetë personalisht ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij, të gjithë veprimet e nevojshme administrative për regjistrimin e këtij vendimi dhe dokumentacionit tjetër përkatës pranë institucioneve kompetente shtetërore.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (ORTAKËT)

DORIAN SADIKU



EDUARD CURRAJ



VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME (ORTAKUT TË VETËM)
TË SHOQËRISË “DELTA PHARMA - AL” SHPK

Sot, në datën 24.02.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) K62202046U, me zyrë qendrore në Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, zona kadastrale 2679, nr. pasurie 19/27/1, Mëzez, Kashar, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) .

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme është prezent ortaku i vetëm i shoqërisë z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- shitjen e kuotës të zotëruar nga z. Eduard Curraj në shoqërinë shoqërisë “DELTA PHARMA-AL” SHPK tek blerësi shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK;
- përcaktimin e çmimit të blerjes,
- miratimin e tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi;
- të ndryshme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm):

V E N D O S I

- 1) Shitjen e kuotës të zotëruar nga z. Eduard Curraj në shoqërinë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, e cila përbën 100% të kapitalit të kësaj shoqërie, tek blerësi shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK.
- 2) Çmimi i shitjes së kuotës do të jetë në vlerën 903,046,506 (nëntëqind e tre milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë. Çmimi i shitjes do të paguhet brenda një afati 10 vjeçar, duke pasur të drejtën palët të ripërtërijnë këtë afat edhe për 5 vjet të tjera, duke marrë parasysh gjendjen financiare të shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK si dhe aktivitetin tregtar të saj.
- 3) Miratimin e tekstit të kontratës së shitblerjes së kuotës, sipas drafut që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 4) Ngarkohet administratori i shoqërisë “DELTA PHARMA-AL” SHPK, që në respektim të zbatimit të këtij vendimit, të kryejë vetë personalisht ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij, të gjithë veprimet e nevojshme administrative për regjistrimin e këtij vendimi dhe dokumentacionit tjetër përkatës pranë institucioneve kompetente shtetërore.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (ORTAKU I VETËM)

EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj

